

ANALIZË E POLITIKËS NDËRKOMBËTARE

Përgjegjësia jonë nuk përfundon në kufijtë e BE-së

Për një politikë të angazhuar të zgjerimit dhe të fqinjësisë së Bashkimit Evropian

**DIETMAR NIETAN, WOLFGANG KREISSL-DÖRFLER,
MARKUS MECKEL, KARSTEN D. VOIGT, KATHARINA ABELS, OLAF BÖHNKE,
STEFAN DEHNERT, ROBERT ERNECKER, SASCHA GÖTZ, KAI-OLAF LANG, NADJA
POHLMANN, KLAUS SUCHANEK**

Prill 2013

- BE-ja duhet të zgjerojë aftësinë e saj të jashtme të veprimit. Për këtë asaj i nevojitet një politikë e rigjallëruar dhe me përgjegjësi në sjelljen me fqinjët e saj dhe me shtetet që janë përfshirë në procesin e zgjerimit.
- Zgjerimi sjell më shumë dobi se sa shpenzime. Një ndalje parimore e zgjerimit do t'i kushtonte shumë Evropës. Andaj procesi i zgjerimit të BE-së duhet të vazhdojë. Zbatimi i kritereve të rrepta dhe i përparimeve, të cilat mund të verifikohen qartë, janë pjesë përbërëse e kësaj, po ashtu sikurse ndershmëria dhe besueshmëria e BE-së – veçanërisht përballë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.
- Partneriteti Lindor i BE-së ka nevojë për një orientim të ri. BE-ja duhet t'ia arrijë që vendet partnere t'i përfitojë në mënyrë të vijueshme për një bashkëpunim të mirë, edhe në qoftë se nuk mundet të ofrojë joshje për perspektivë konkrete të anëtarësimit. Kjo kërkon një angazhim më të fortë të BE-së.
- Nga Gjermania si shteti anëtar i BE-së me ndikim kërkohet që të punojë për më shumë besueshmëri, çiltërsi, transparencë, solidaritet dhe angazhim në Politikën Evropiane të Zgjerimit dhe të Fqinjësisë.

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Edhe në kohërat e krizës në agjendë: dimensionimi i jashtëm i Evropës.....	3
I. POLITIKA E ZGJERIMIT	3
Zgjerimi i BE-së është një tregim i suksesit.....	3
Zgjerimi sjell më shumë dobi se shpenzime.....	4
Një ndalje parimore e zgjerimit do t'i kushtonte shtrenjtë Evropës.....	4
Edhe një BE e zgjeruar mbetet e aftë për veprim.....	5
Me kë negociacion BE-ja për një anëtarësim?.....	5
Ndershmëri dhe besueshmëri përballë vendeve të Ballkanit Perëndimor.....	5
Ndershmëri dhe besueshmëri përballë Turqisë.....	6
Konkluzione.....	7
II. POLITIKA E FQINJËSISË	8
Politikës evropiane të fqinjësisë i mungon vrulli	9
Të zhvillohet më tej Partneriteti Lindor	9
Rusia të përfshihet si partner strategjik.....	9
Kushtëzimi: Mjet i nevojshëm presioni apo frenues?.....	10
Anëtarësimi në BE: jo në agjendë, por nuk përjashtohet kategorikisht.....	10
Konkludimet:.....	10
Përfundim	12

Hyrje

Pas shekujve të balancave të vështira të forcës dhe pas katastrofës së të dyja luftërave botërore, në Evropë është arritur përmes integritit të shteteve, që të krijohet paqja mes popujve. U rrëzuan diktaturat dhe u vendosën demokracitë. Prej një regjioni të munduar nga luftërat u krijua tregu i brendshëm më i pasur dhe më i madh në botë.

Mirëpo, aktualisht BE-ja gjendet në fazën me sa duket më të vështirë që nga themelimi i saj. Kriza e borxheve dhe e refinancimit ka arritur përmasën ekzistenciale, përfundimi i saj është i pasigurt. Shtetet anëtare luftojnë për kompaktësi dhe për zgjidhje të qëndrueshme. Unitet ekziston në bindjen themelore, se një shkatërrim i Bashkimit Evropian do të ishte një prapavajtje për politikën e integritit me pasoja të paparashikueshme negative. Një prapavajtje e tillë do t'i rëndonte shumë gjasat e së ardhmes për gjeneratat e ardhshme.

Edhe në kohërat e krizës në agjendë: dimensionimi i jashtëm i Evropës

Konsolidimi i brendshëm ka rëndësi qendrore dhe vendos të gjithë aktorët evropianë para sfidave të mëdha. Forcimi i aftësisë për veprim të jashtëm të BE-së është po aq i rëndësishëm. Shtetet e tjera i sendërtojnë interesat e tyre politike dhe ekonomike në botë duke vepruar ndaras dhe me konceptet e tyre fitojnë gjithnjë e më shumë ndikim, edhe jashtë Evropës dhe në fqinjësinë e drejtpërdrejtë evropiane. Në balancën ndërkombëtare të fuqisë Evropa nuk guxon të zhytet në parëndësishmëri. Për ardhmërinë e kontinentit tonë dhe për gjeneratat që jetojnë aty është me rëndësi esenciale, që tani të jepen drejtimet për një Evropë të bashkuar dhe solidare, e cila është e aftë t'i përballojë sfidat e zhvillimeve globale. Bashkimi Evropian do të sfidohet gjithnjë e më fort për të vepruar në rrafshin ndërkombëtar – jo vetëm ekonomikisht, por edhe politikisht dhe ushtarakisht. Me të drejtë Shtetet e Bashkuara të Amerikës si aleatë më të rëndësishëm të evropianëve e shikojnë BE-në gjithnjë e më shumë në detyrën për të qenë aktor i pavarur global. Vetë SHBA-të ndjekin një politikë gjithnjë e më të përmbajtur sa i përket hapësirave para derës së Evropës. Krahas Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) dhe Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (PPSM) BE-së i duhet për këtë arsye edhe një politikë e rigjallëruar, përgjegjëse dhe e qëndrueshme në sjelljen me fqinjët e saj dhe me shtetet që janë përfshirë në procesin e zgjerimit.

I. POLITIKA E ZGJERIMIT

Zgjerimi i BE-së është një tregim i suksesit

Shtetet e BE-së përkatësisht të UE-së, përmes anëtarësimit të shteteve anëtare gjithnjë e më të reja dhe përmes komunitarizimit të shumë fushave politike, janë bërë zona më e madhe në botë për tregti të lirë. Por, ato janë para së gjithash hapësirë e përbashkët historikisht e pashembullt e lirisë, e së drejtës dhe e bashkëjetesës paqësore të shumë popujve. Vlen ta thërrasim këtë gjithherë në kujtesën tonë. Mundësia e aderimit të shumë shteteve anëtare, megjithatë, vihet shumë herë në pyetje, edhe pse neni 49 par. 1 i TBE-së flet një gjuhë të qartë dhe të saktë: “Çdo shtet evropian, i cili respekton vlerat e përmendura në nenin 2 dhe angazhohet për promovimin e tyre, mund të kërkojë që të bëhet anëtar i Unionit. (...)” Duke marrë parasysh krizën aktuale të BE-së, përveç kësaj po shtohen edhe

pyetjet, se a është BE-ja administrativisht, politikisht dhe ekonomikisht në gjendje për të përballuar anëtarë të mëtejme dhe se zgjerimi mos i qëndron në rrugë një thellimi të bashkëpunimit të shteteve të tanishme anëtare. Procesi i dështuar kushtetues, vështirësitë e mëdha gjatë bisedimit dhe ratifikimit të Traktatit të Lisbonës, por edhe gjendja e zhvillimeve në vendet candidate (potenciale), krahas krizës së borxheve dhe të rifinancimit e fuqizojnë vlerësimin, se raundet e mëtejme të zgjerimit të BE-së janë të përfytyrueshme në rast nevojë në të ardhmen e largët.

Zgjerimi sjell më shumë dobi se shpenzime

Nga anëtarësimi i vendeve të Evropës së Mesme dhe Lindore më 2004 kanë përfituar dukshëm, politikisht si dhe ekonomikisht, jo vetëm ato vetë, por edhe BE-ja. Qysh në periudhën kohore mes fillimit të bisedimit dhe të anëtarësimit eksportet e BE-së në shtetet e aderuara janë më shumë se trefishuar. Një pjesë jo e parëndësishme e shkallëve të larta të rritjes në shtetet e anëtarësuar në këtë periudhë kohore vjen si pasojë e procesit të zgjerimit.

Për ekonominë e Gjermanisë, e cila është e orientuar fuqishëm kah eksporti, përmes zgjerimit të BE-së kanë dalë përparësi të mëdha. Në anën tjetër mungoi vërsulja e drujtur kah tregjet e punës të vendeve “të vjetra” të BE-së. Shtetet e BE-së nga Evropa e Mesme dhe Lindore qëndrojnë në krizë më mirë se ndonjë anëtar shumëvjeçar. Harxhimeve financiare për zgjerim po u qëndron përballë një dobi edhe më e madhe për të dyja palët. Duhet të thuhet qartë: Kriza aktuale i zbulon në radhë të parë dobësitë e shteteve “të vjetra” anëtare dhe jo gabimet e “të reja”.

Ujdia e përtëritur për zgjerim, të cilën e ka miratuar Këshilli Evropian në qershor 2006, e ka theksuar edhe një herë sinkronizimin e thellimit dhe të zgjerimit përmes bisedimeve të rrepta për anëtarësim. Tek proceset e mëtejme të anëtarësimit do të duhej të përjashtoheshin zbritjet politike në kuptimin e zbutjes së kriterëve për anëtarësim ose politizimi i procesit të anëtarësimit siç është përcaktimi i parakohshëm i datave të anëtarësimit. Anëtarësimet e ngutura të Bullgarisë dhe Rumanisë tregojnë se anëtarësimi nuk çon automatikisht deri te stabiliteti, përparimi ekonomik dhe kultura demokratike të ankoruara thellë. Në ndërkohë u nxorën megjithatë konsekuencat, të cilat mundësojnë që në ardhmen të shmangen gabimet e tilla dhe të mënjahen gradualisht gabimet që u bënë në të kaluarën.

Një ndalje parimore e zgjerimit do t'i kushtonte shtrenjtë Evropës

Procesi i zgjerimit nuk guxon të ndalet, por duhet të vazhdohet me kushte të përkufizuara qartë dhe me monitorim të përforcuar. Pasojat negative të një ndaljeje parimore të zgjerimit do të ishin të mëdha për Evropën. Në qoftë se zhvendoset perspektiva evropiane, ekziston rreziku që vendet përkatëse t'ia kthejnë shpinën BE-së dhe t'iu drejtohen partnerëve të tjerë. Sukseset tashmë të arritura në fushën e demokracisë, të qeverisjes së mirë ose të pajtimit me fqinjët do të viheshin në pyetje ose madje do të thyheshin. Nacionalizmi në rritje e sipër, stabiliteti në rënie dhe konfliktet e rishfaqura do të ishin pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë, i cili fundja do ta dëmtonte shumë politikisht dhe ekonomikisht edhe BE-në. Një perspektivë e besueshme evropiane mbetet e rëndësishme për të përforcuar paqen, demokracinë dhe stabilitetin në fqinjësinë tonë të drejtpërdrejtë evropiane.

Pas anëtarësimit të afërt të Kroacisë në BE dhe eventualisht të Islandës, me gjasë do të kalojnë shumë vjet derisa të vijnë anëtarësimet e mëtejme. Një pauzë në procesin e

përafritim përkatësisht të negocimit mes BE-së dhe vendeve candidate, një lejim i fashitjes së dinamikës, megjithatë, nuk mund të lejohet që të justifikohet në këtë mënyrë. Përpjekja e të dyja palëve për njëra-tjetrën nuk guxon të ndalet, BE-ja dhe shtetet e saj anëtare duhet ta ruajnë dhe ta rrisin angazhimin e tyre.

Edhe një BE e zgjeruar mbetet e aftë për veprim

Politikisht përmes parimit të unanimitetit të një numër në rritje i shteteve anëtare kanë me të vërtetë bllokimi i procesit të vendimmarrjes. Traktati i Lisbonës e ka përballuar parimin e unanimitetit në shumë fusha dhe ka mundësuar dukshëm më shumë vendime me shumicë të dyfishtë. Përveç kësaj u zgjerua mundësia për bashkëpunim të përforcuar. Të dy rregullimet përmirësojnë aftësinë e veprimit të BE-së. Shpejtësia, me të cilën 27 shtetet anëtare të BE-së përkatësisht 17 vendet e eurozonës marrin vendime edhe me rëndësi të madhe dhe vendimet mund t'i shqyrtojnë në parlamentet e tyre kombëtare, tregon: 27 vendet e BE-së janë në gjendje që në kuadër të Traktatit të Lisbonës të marrin vendime të rëndësishme, përderisa për këtë ekziston vullneti politik. Nuk mund të dallohet, se pse kjo aftësi e veprimit parimisht të mos ishte më e pranishme në një BE me 28, 29 apo më shumë shtete anëtare. Por, kjo nuk do të thotë se në të ardhmen nuk do të ketë nevojë për ndryshimet në rregulloret e BE-së, për shembull për një zgjerim edhe më të fuqishëm në marrjen e vendimeve të shumicës.

Me kë negocion BE-ja për një anëtarësim?

Procesi i anëtarësimit të Kroacisë në BE gati se është përmbyllur. Konkretisht BE-ja përveç kësaj, krahas me Islandën, negocion aktualisht me Malin e Zi dhe me Turqinë. Serbia dhe ish-Republika jugosllave e Maqedonisë presin si vende candidate hapjen e negociatave. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova janë vende candidate potenciale, të cilat megjithatë ende nuk kanë parashtruar kërkesën për anëtarësim. Në qoftë se BE-ja dëshiron të ruaj besueshmërinë e saj, ajo duhet t'i vazhdojë sinqerisht, ndershëm dhe transparent proceset e negocimit, të dialogut dhe të anëtarësimit me vendet e përmendura.

Ndershmëri dhe besueshmëri përballë vendeve të Ballkanit Perëndimor

BE-ja duhet të këmbëngulë në kushtet e saj, por njëkohësisht të përmbushë premtimet e saj të dhëna më 2003 në Selanik dhe parimisht të ruajë perspektivën evropiane për Ballkanin Perëndimor. Ballkani Perëndimor në afat të gjatë nuk guxon të mbetet njollë e bardhë në hartën e BE-së. Një angazhim i fortë i BE-së dhe i shteteve të saj anëtare me këtë rast nuk guxon të lidhet vetëm me procesin konkret të zgjerimit. Shtetet e Ballkanit Perëndimor meritojnë dhe kanë nevojë për solidaritetin e Evropës.

Nënshkrimi i marrëveshjes së anëtarësimit me Kroacinë më 2011 dhe shpallja e statusit të kandidatit për Serbinë më 2012 ishin momente domethënëse për integrimin evropian. Para së gjithash zhvillimi i Kroacisë është një dëshmi për atë, se pas luftërave shkretuese në Ballkan në vitet e 1990-ta në regjion janë gjithsesi të arritshme paqja, stabiliteti, demokracia e fundja edhe anëtarësimi në BE. Në shembullin e Kroacisë më së miri mund të dëshmohet, se çfarë force transformuese bartin në vete politika e BE-së për zgjerim dhe si mund të sillt kështu dinamika e re në procesin reformues të vendeve të tjera të zgjerimit. Andaj do të ishte pikërisht e papërgjegjshme që vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor t'u sinjalizohej, se ato

nuk janë të mirëseardhura në BE. Vërtet regjioni është heterogjen, por prapëseprapë shumë vende kanë të njëjtën gjendje problematike, zgjidhja e të cilave do të stimulohej në mënyrë vendimtare përmes një perspektive për anëtarësim në BE. Pikërisht perspektiva e anëtarësimit është pika vendimtare, e cila fuqizon forcat demokratike dhe reformatore në këto vende dhe favorizon proceset rrjedhëse të reformave.

Edhe këtu vlen: Kush dëshiron të anëtarësohet, duhet t'i përmbush kriteret përkatëse dhe t'i ndajë vlerat evropiane. Vendet e Ballkanit Perëndimor në këtë kuptim duhet të përballojnë sfida të mëdha, sepse nacionalizmi, korrupsioni dhe krimi janë të përhapura gjerë e gjatë dhe paraqesin pengesa në rrugën e integritimit evropian. Kësaj i shtohen probleme të mëdha ekonomike dhe sociale. Reformat kushtetuese në Bosnjë dhe Hercegovinë, marrëdhëniet e tensionuara mes Serbisë dhe Kosovës, përkrahja e demokracisë, sundimit të ligjit, liria e medieve dhe transparenca në Mal të Zi, Shqipëri dhe ish-Republikën jugosllave të Maqedonisë – të gjitha këto janë punishte të rëndësishme para sfondit të një perspektive të anëtarësimit. Edhe ndalja e konflikteve bilaterale si dhe regjionale dhe njohja e kufijve ekzistues duhet të jenë kushte për një anëtarësim në BE. Përveç kësaj, është e rëndësishme që të zgjerohet dhe të thellohet kooperimi regjional ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ndershmëri dhe besueshmëri përballë Turqisë

Turqia është sigurisht kandidati më diskutabil për anëtarësim në BE. Në Gjermani dhe në disa vende të tjera anëtare të BE-së me vite instrumentalizohet në politikën partiake aderimi i Turqisë në BE, edhe pse të gjitha shtetet anëtare të BE-së kanë aprovuar nisjen e bisedimeve për anëtarësim.

BE-ja dhe shtetet e saj anëtare duhet të qëndrojnë pranë perspektivës së dhënë për anëtarësim. Mirëpo, duhet marrë po ashtu parasysh, se politika e tanishme e qeverisë Erdoğan e vë në një pozitë të vështirë BE-në si partner bisedimi. Në njërën anë qëndron një Turqi, e cila në vitet e fundit ka ndryshuar shumë, edhe falë procesit të anëtarësimit në BE. Reforma të shumta u zhvilluan, procesi i demokratizimit u çua përpara, ekonomia po lulëzon. Në anën tjetër qëndrojnë zhvillime brengosëse: Në politikën e brendshme kufizohet liria e shprehjes, gazetarët arrestohen, konflikti me minoritetin kurd shpërthen vazhdimisht. Me vendimin për të mos zhvilluar raporte me presidencën qipriote të Këshillit të BE-së, Turqia e ka zemëruar BE-në dhe vetes nuk i ka bërë kurrfarë të mire. Politika e Erdoğanit në këtë pikë është kontraproduktive për procesin e anëtarësimit në BE.

Bisedimet për anëtarësim mes BE-së dhe Turqisë kanë ngecur. Megjithatë: Perspektiva parimore për anëtarësim në BE për popullsinë e një vendi nuk guxon të kushtëzohet me atë, se cila qeveri tani e mban përgjegjësinë. Shumë u arrit deri më tani. Prosesi i reformave dhe i demokratizimit duhet të vazhdojë. Pikërisht për shkak të sukseseve të saj ekonomike Turqia ka fituar vetëbesim. Ajo paraqitet gjithnjë e më shumë si fuqi regjionale në politikën e jashtme dhe në politikën e sigurisë. Si e tillë ajo fiton rëndësi për BE-në, para së gjithash në aspektin e stabilitetit në regjionin MENA (Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore) dhe si aktor në politikën energjetike. Duke marrë parasysh negociatat e ngecura të anëtarësimit duhet zhvilluar edhe forma të reja për një kooperim të ngushtë mes BE-së dhe Turqisë. Nuk ka kuptim që të ngulitemi në negociata për anëtarësim, nëse ato nuk çojnë përpara. “Agjenda pozitive” e Komisionit të BE-së është një pikënisje e tillë. Mirëpo, ajo duhet të kufizohet qartë nga propozimi i një “Partneriteti të privilegjuar” nga qarqet konservative, i cili do të duhej të paraqiste një zëvendësim të përhershëm për një anëtarësim në BE. BE-ja dhe Turqia mund

të ecin rrugëve të reja pa hequr dorë me këtë rast nga procesi i anëtarësimit. Një përparim qendror do të ishte me këtë rast zbatimi i liberalizimit të vizave me Turqinë që është dashur qëmoti të fillojë. Për paqen dhe stabilitetin në Evropë dhe në regjionet e saj fqinje rëndësi posaçërisht të theksuar krahas Federatës Ruse ka edhe Turqia. Kjo duhet të pasqyrohet edhe në të gjitha politikat e BE-së, sidomos në fushat e PPJS-së dhe të ENP-së.

Konkluzione

Brengat nga mbingarkimi i BE-së janë të paarsyeshme. Raundet e fundit të zgjerimit kanë treguar qartë: Shtetet e reja anëtare, të cilat i përmbushin të gjitha kriteret për një anëtarësim në BE, janë një fitim. Në mënyrë që të ruhet aftësia e integritit dhe të ardhmes së BE-së, duhet që Kroacia, Serbia, Mali i Zi, ish-Republika jugosllave e Maqedonisë, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria dhe Kosova si dhe Turqia, të ndërmarrin përpjekje të mëdha për reforma dhe t'i përmbushin të gjitha kriteret e nevojshme. Mirëpo, njerëzit në këto vende duhej të kenë mundësinë të besojnë, se dora e BE-së do të mbetet e zgjatur. Jo kot çmimi Nobel për paqe iu dha më 2012 BE-së me arsyetimin për ndikimin paqeruajtës të zgjerimit të saj. Në këtë ndikim duhet të besohet edhe në të ardhmen.

Një politikë e suksesshme e zgjerimit do të duhej të qëndrojë mbi transparencë, besueshmëri dhe ndershmëri dhe të marrë parasysh si vijon:

1. BE-ja duhet të jetë e sigurtë, e çiltër dhe e besueshme. Deklarimi i BE-së për mundësinë e aderimeve të tjera duhet të jetë i qartë dhe pa dy kuptime. BE-ja dhe shtetet e saj anëtare duhet të tregojnë përmes veprimeve të tyre, se kanë vetë interesim për pranimin e anëtarëve të tjerë, përderisa janë përmbushur të gjitha kushtet. Premtimi i dhënë njëherë për perspektivën e aderimit duhet të mbahet.

2. Kriteret e rrepta dhe përparimet që mund të verifikohen qartë, janë kushtet e pashmangshme themelore për një proces të suksesshëm të zgjerimit. Kriteret e Kopenhagës paraqesin edhe pas 20 vjetësh bazën e çmueshme dhe thelbin e zgjerimit. Një proces i përmirësuar i monitorimit përmban shansin e madh, që procesi i aderimit të konceptohet në mënyrë transparente dhe eficiente dhe me këtë të rritet edhe pranueshmëria e strategjisë së aderimit në shtetet anëtare të BE-së. BE-ja duhet të garantojë transparencën e bazave të saj të vlerësimit dhe të veprimit të saj. Nuk guxon kurrsesi të vjen deri te zbutja e kriterëve. Çrregullimet duhet të kritikohen qartë dhe hapur. Në programet strategjike të vendeve aderuese dhe në programimin e ndihmave për përafrim, në lidhje me kërkesat qendrore siç janë për shembull demokracia, transparenca, sundimi i ligjit, liria e shtypit ose sjellja me minoritete, duhet të përcaktohen pika referimi të verifikueshme, të cilat mundësojnë përdorimin jo vetëm të parimit *more for more* por edhe *less for less*.

3. Negociatat për anëtarësim duhet të fillojnë mundësisht herët dhe të zgjasin më gjatë. Është treguar shumë herë, se negociatat për anëtarësim në BE janë motori më i fuqishëm për reforma në vendet candidate. Vetë procesi i negocimit, për këtë arsye, do të duhej të fillonte më herët dhe të zgjaste tërësisht më gjatë, ashtu që efekti i fortë reformues i negociatave për aderim të nisët herët dhe të mund të shfaqë efekt të qëndrueshëm. Për t'iu transmetuar vendeve anëtare sikurse edhe BE-së përjetime të suksesit gjatë negociatave shumëvjeçare të anëtarësimit, duhet të arrihen qëllime të ndërmjetme të arritshme, të cilat janë të kuptueshme dhe të ndjeshme për njerëzit.

4. Sundimi i ligjit duhet të qëndrojë në qendër të negociatave. Strategjia e re e Komisionit Evropian, që në ardhmen fokusi më i fortë të vendoset në sundimin e ligjit dhe në reformat e administratës publike dhe që kapituajt 23 dhe 24 të negociatave të hapen në vijë të

parë dhe të mbyllen si të fundit, është e saktë. Këtu duhet të arrihen përparime bindëse që nga fillimi. Përmes kësaj, kandidatët për aderim mund të fillojnë me kohë me reformat në fushat themelore, të cilat sipas përvojës marrin më shumë kohë, por njëkohësisht janë edhe kusht dhe motor për reforma të suksesshme në fusha të tjera. Tashmë edhe para fillimit të bisedimeve zyrtare për anëtarësim do të duhej të përpunohen së bashku përmbajtjet e kapitujve 23 dhe 24, mundësisht në kuadër të bisedimeve paraprake.

5. Proceset e anëtarësimit duhet të jenë transparente për popullsinë e shteteve anëtare të BE-së. Qysh para shpërthimit të euro-krizës në pjesë të gjera të popullsisë së shteteve anëtare të BE-së ishin të mëdha rezervat ndaj pranimi të vendeve të tjera. Që dyshimi është forcuar edhe më tej, duke marrë parasysh situatën e krizës, është e kuptueshme. Ky dyshim duhet të merret seriozisht, por nuk guxon të keqpërdoret për atë, që me mjete populiste të nxitet frikë nga zgjerimi i BE-së. Tema e zgjerimit nuk guxon të heshtet tërësisht. Jo vetëm Komisioni i BE-së, por edhe aktorët politikë në shtetet e veçanta anëtare duhet t'i paraqesin dhe t'i sqarojnë hapur e vazhdimisht qëndrimet e tyre dhe të kërkojnë pëlqimin për ato.

6. Në procesin e përafrimit në BE dhe gjatë procesit të aderimit duhet të përfshihen shoqëria civile dhe nivele të ndryshme të vendit kandidat. Një opinion kritik në vendin kandidat dhe vlerësimi i tij i zhvillimeve do të duhej të gjejnë dëgjim në BE. Vetëm në qoftë se anëtarësimi në BE dhe reformat e lidhura me atë ndjehen dhe përkrahen si përparim edhe nga shoqëria, atëherë vërtet do të ngadhënjej integrimi. Me këtë rast vlen të përfshihen nivelet e ndryshme, madje deri te strukturat komunale.

Sa i përket procesit të monitorimit, përtej mekanizmave tashmë ekzistuese, do të mund të merrej parasysh edhe një përfshirje e forcuar e shoqërisë civile dhe krijimi i misioneve vëzhguese, të financuara përmes një faciliteti të zgjeruar për mbështetjen e shoqërisë civile. Më tutje do të ishte për t'u shqyrtuar, se leximi i parë i drafteve të raporteve të progresit në formën e një tryeze të rrumbullakët mes qeverisë dhe shoqërisë civile në vendin përkatës kandidat a do të jepte një kontribut për pranimin nga shoqëria të kanunit të vlerave të komunitetit. Raportet e progresit nga BE-ja mbështeten shpesh në informatat e qeverive përkatëse. Përfshirja e perspektivave nga shoqëria civile ose nga nivelet nën qeveri do të duhej të intensifikoheshin, në mënyrë që të rritet pesha e raporteve të progresit.

7. Aspektet sociale duhet të përfshihen edhe më fort. Sfidat sociale dhe shoqërore si papunësia, mungesa e perspektivës për të rinjtë, distanca në rritje mes varfërisë dhe pasurisë, ndryshimi demografik, barazia e gjasave dhe drejtësia sociale, migrimi dhe integrimi nuk shqetësojnë vetëm shtetet anëtare të BE-së, por janë tejet aktuale pikërisht edhe për vendet candidate (potenciale). Kjo bëhet tejet e qartë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Prandaj, aspektet e tilla do të duhej të peshohen me vëmendje më të madhe dhe të zhvillohen më shumë strategji të përbashkëta.

8. Asnjë vend nuk do të ketë zbritje politike. Pengesat për anëtarësimin e vërtetë nuk guxojnë të ulen edhe në rast të një fillimi më të hershëm të bisedimeve. Kushtet e përcaktuara më parë nga BE-ja duhet të jenë të përmbushura pa përjashtim.

II. POLITIKA E FQINJËSISË

Bashkimi Evropian me politikën e saj të fqinjësisë ndjek qëllimin që në fqinjësinë e saj të mbështeten prosperiteti, stabiliteti si dhe paqja dhe siguria. Kjo këtë e bënë me synimin, që të përmirësojë situatën në vendet e saj fqinje, e cila shkon edhe në të mirë të interesave të saj ekonomike dhe të sigurisë. Me këtë rast për BE-në dhe për shtetet e saj anëtare bëhet

fjalë për pengimin e luftës, të dhunës dhe të pasojave të tyre (p.sh. migrimi i pakontrolluar), për përhapjen e konceptit të vet të vlerave (respektimi i të drejtave të njeriut, rendi liberal-demokratik, sundimi i ligjit, ekonomia e tregut) si dhe për qasjen në tregjet e mallrave dhe në resurse (lëndët e para, energjia, fuqia e kualifikuar punëtore). Përmes përafritit kah BE-ja shtetet jo-anëtare në BE presin mirëqenie në rritje, stabilitet politik dhe ekonomik si dhe paqe dhe siguri. Por, njëkohësisht edhe vende të tjera në fqinjësi të drejtpërdrejtë me BE-në ndjekin – jo pa sukses – interesat e tyre politike dhe ekonomike për të fituar ndikim.

Politikës evropiane të fqinjësisë i mungon vrulli

Politikës evropiane të fqinjësisë si jugore ashtu edhe asaj lindore i mungon vrulli. Kështu, për shkak të mungesës së rezultateve konkrete, ishte e dështuar iniciativa franceze e një Unioni Mesdhetar qysh moti para shpërthimit të rebelimit arab, përballë së cilës BE-ja u tregua e stërlodhur. Është urgjentisht e nevojshme, që BE-ja dhe shtetet e saj anëtare të zhvillojnë strategji të reja, efikase për kooperim me shtetet fqinje në jug dhe me vendet arabe në tranzicion për të përkrahur stabilizimin e tyre demokratik dhe ekonomik.

Në vazhdim do të duhej të bëhej fjalë megjithatë për Partneritetin Lindor (PL). Këtu Gjermania do të duhej të merrte pjesë në masë të posaçme në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave të reja. Propozimet për regjionin MENA (Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore) do t'i paraqesim në një letër të ndarë.

Të zhvillohet më tej Partneriteti Lindor

Partneriteti Lindor i krijuar mbi iniciativën polako-suedeze, ka nevojë për një riorientim. Në gjashtë vendet e Partneritetit Lindor (Bjellorusi, Ukrainë, Republikën e Moldavisë, Azerbajxhan, Armeni dhe Gjeorgji), BE-ja ndjek cakun që të stabilizojë fqinjësinë e saj, ashtu që kontribuon në suksesin e tyre ekonomik dhe në zhvillimin e demokracisë së themeluar mbi sundimin e ligjit. Nga këndvështrimi i BE-së një politikë e tillë shkon edhe në interes të Ruisë. Mirëpo, Rusia këtë deri më tani e shikon ndryshe: Ajo i vështron shumicën e vendeve të PL-së si fushë të ndikimit të saj, në fillim e vlerësoi krijimin e PL-si si fyerje dhe hodhi poshtë ofertat për bashkëpunim në këtë kuadër. Përafritimi me BE-në për vendet e PL-së nuk është kurrësi pa alternativa. Përkundrazi: Këto vende kërkojnë aktivisht koncepte për zhvillimin e vet. Disa lëkunden mes lidhjes më të ngushtë me Rusinë, me BE-në ose me Turqinë dhe Kinën. Se a do të bëhet BE-ja partner i preferuar për vendet e regjionit, varet nga atraktiviteti i politikës së saj. Në këtë regjion BE-ja do të duhej ta favorizonte tranzicionin përmes kooperimit, në vend që të kërkojë një kthesë tashmë të ndërmarrë.

Rusia të përfshihet si partner strategjik

Përkundër zhvillimeve aktualisht brengosëse brenda-shtetërore brenda Federatës Ruse në lidhje me mandatin e tretë të presidentit Putin, Rusia është dhe mbetet një partner shumë i rëndësishëm strategjik i BE-së, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht. Edhe në qoftë se BE-ja dhe Rusia janë të mendimeve të ndryshme në çështjet e Partneritetit Lindor, BE-ja ndaj Ruisë duhet ta bëjë edhe më tej të qartë, se politikën e saj të fqinjësisë nuk e drejton kundër Ruisë. Andaj dialogu me Rusinë duhet të jetë pjesë përbërëse e politikës për partneritetin lindor. Një “Luftë e ftohtë” për vendet e PL-së nuk është as në interes të atyre vetë, e as në interes të BE-së përkatësisht Ruisë, Kinës apo Turqisë. Përkundrazi: të bashkëpunosh në

mënyrë konstruktive me lojtarët e tjerë të mëdhenj, është në interes të të gjithë pjesëmarrësve.

Kushtëzimi: Mjet i nevojshëm presioni apo frenues?

Bashkimi Evropian ka punë me partnerë të vështirë në Partneritetin Lindor: Ato vende shfaqin deficite të rënda në lidhje me sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Për politikën e zgjerimit është e rëndësishme që BE-ja përdor një kushtëzim të rreptë, sepse vetëm kështu mund të ruhet aftësia vepruese e një BE-je të zgjeruar. Edhe në politikën e fqinjësisë BE-së i duhen joshjet dhe “mjetet e presionit”. Përdorimi i kushtëzimit të rreptë megjithatë e bënë të vështirë bashkëpunimin. BE-ja duhet të qëndrojë pranë vlerave të saj, që të emërtohen hapur çrregullimet dhe të kërkohen reformat, përndryshe ajo humb çdo besueshmëri. Njëkohësisht vendet partnere duhet të merren aty ku qëndrojnë, sepse kushtëzimi përndryshe do të bëhej shpejt frenues. Ndryshimi i thellë në frymën e vlerave evropiane nuk mund të jetë parakusht për dialog dhe kooperim, ai mbetet objektiv i tyre. Një politikë e hapave të vegjël mund të arrijë shumë, para së gjithash në qoftë se krahas qeverive – shpeshherë të pakëndshme – përfshihen edhe forcat progresive në nivelet e ndryshme si dhe popullsia.

Anëtarësimi në BE: jo në agjendë, por nuk përjashtohet kategorikisht

Çështja e një anëtarësimit në BE tani për tani dhe për një kohë të konsiderueshme nuk parashtrahet për asnjërin nga vendet e PL-së. Kjo është një sfidë tjetër e madhe për dizajnimin e politikës evropiane, pasi që perspektiva e anëtarësimit gjithsesi shumëfish është dëshmuar si motori më i fortë i reformave dhe si faktori i lidhjes. Mirëpo, aderimi i vendeve të përmendura nuk mundet edhe të përjashtohet kategorikisht për të gjitha kohërat, siç rezultojnë edhe nga neni 49 par. 1 i Traktatit të Bashkimit Evropian. Për më tepër, ai duhet të bëhet i varur nga zhvillimi i ardhshëm i secilit vend të veçantë. Politika e fqinjësisë duhet pra t’ia arrijë që vendet partnere t’i përfitojë përgjithmonë për një bashkëpunim të ngushtë dhe të mirë, pa mundur të ofrojë me atë rast joshjen e një perspektive konkrete të anëtarësimit.

Politika e fqinjësisë nuk guxon të duket si një kopje e një politike të zgjerimit pa perspektivë të anëtarësimit. Kjo kërkon një përforsim të angazhimit të BE-së në tërësi, por edhe impulse të reja për instrumentet e Partneritetit Lindor.

Konkluzionet:

1. Marrja përsipër e parimeve ligjore dhe demokratike nuk mund të bëhet *conditio sine qua non* e çdo kooperimi. Parimi i formuluar nga Komisioni i BE-së i *more for more* nuk guxon të keqkuptohet si një *more or nothing*. Parimi i “shpërblimit” të përparimit përmes ndihmave të përforsuara, bashkëpunimit të intensifikuar dhe hapjes graduale të tregut mbetet i drejtë. Mirëpo, nuk është e drejtë të përjashtohet çdo kooperim në rast të mungesës së këtyre përparimeve. Reformat themelore në frymën e vlerave evropiane duhet të jenë objektivi, por nuk mund të jenë parakushti i bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe vendeve të PL-së.

2. Duhet të merren parasysh dallimet në pikënisjet politike. Kooperimi me shtetet që nuk zgjedhin rrugën e demokracisë dhe të sundimit të ligjit, duhet të diferencohet qartë nga bashkëpunimi i thelluar me partnerët e avancuar që përqafojnë demokracinë dhe sundimin e

ligjit. Vendet si Azerbajxhani apo Bjellorusia, të cilët janë deklaruar se nuk kanë interesim për një zhvillim në këtë drejtim, nuk do të duhej të trajtohen me të njëjtën pikënisje politike sikur për shembull Ukraina ose Republika e Moldavisë, të cilat lëvizin drejt një perspektive evropiane.

3. Kooperimi në kuadër të Partneritetit Lindor duhet të përfshijë shoqërinë civile dhe nivelet e ndryshme. Të gjitha masat, por edhe vendimet parimore për apo kundër hapave të caktuara reformuese duhet të diskutohen si me autoritetet shtetërore ashtu edhe me aktorët e shoqërisë civile. Ndryshimi shkaktohet përmes përafrimit mbi bazë të gjerë, pra përmes shkëmbimit ekonomik, politik, kulturor dhe shoqëror në të njëjtën masë. Në përputhje me këtë, forumet e shoqërisë civile, por edhe zbatimi i programeve të suksesshme të BE-së duhet të zgjerohen kah shtetet partnere. Një kooperim i përforcuar me nivelet poshtë qeverive, për shembull në nivelin komunal, për popullsinë mund të arrijë kontakte dhe përparime që ndoshta mund të ndjehen shpejt.

4. Negociatat për Marrëveshje të Asocimit, Marrëveshje të Tregut të Lirë dhe lehtësimet për viza duhet të çohen përpara. Negociatat me vendet e veçanta të PL-së kanë arritur përparime të ndryshme dhe duhet të çohen përpara me këmbëngulje. Dështimet sikurse në bisedimet për Marrëveshjen e Asocimit me Ukrainën janë zhgënjyese, por nuk guxojnë të çojnë në ndërprerjen e tërë procesit ose në fashitjen e përpjekjeve. Lehtësimet e dhënies së vizave janë një faktor kyç gjatë përafrimit, ngaqë pikërisht përmes udhëtimit Evropa bëhet e prekshme për njerëzit në vendet partnere.

5. Vendet e Partneritetit Lindor mund të koepojnë si me BE-në ashtu edhe me partnerët e tjerë. Që vendet e Partneritetit Lindor kanë interesim të madh për kooperim me fqinjët e tyre të madh dhe me ndikim Rusinë, me Turqinë ose edhe Kinën, është e vetëkuptueshme. Si shtete sovraane ato janë të lirë për kooperim me partnerë të ndryshëm. Derisa ato nuk duan të aderojnë në BE, nuk guxon as të ndërtohet një “konkurrencë e integritetit” në kuptimin e një ose-ose. Kështu Ukraina mund të bashkëpunojë edhe në fushat e një unioni doganor të iniciuar nga Rusia, të cilat nuk qëndrojnë në kundërtë me Marrëveshjen e Asocimit të negociuar mes BE-së dhe Ukrainës. Në qoftë se bashkëpunimi me BE-në për vendet përkatëse është joshës dhe nxit ndryshime pozitive dhe të prekshme, atëherë këtij bashkëpunimi do t’i jepet rëndësia përkatëse.

6. BE-së i duhet një politikë e ndershme dhe ofensive e informimit. Dialogu me vendet e PL-së duhet të shoqërohet nga një politikë ofensive e informimit. Kjo politikë e informimit është e nevojshme si asnjëherë më parë, duke marrë parasysh krizën aktuale të ekonomisë dhe të borxheve shtetërore. Sepse në kuptimin e “aftësisë konkurruese” të modelit evropian ekonomik dhe social, është vendimtare që të paraqitet në mënyrë ofensive aftësia e BE-së për zhvillim të mëtejshëm dhe për zgjidhje solidare të problemeve. Sepse dyshim për Evropën nuk ka vetëm në BE, por edhe në vendet fqinje. Këtij dyshimi duhet kundërvënë me politikë të hapur dhe të ndershme, por edhe të vetëdijshme të informimit.

7. BE-ja duhet të harmonizohet më mirë. Shtetet e veçanta anëtare të BE-së kanë pjesërisht interesa me karakteristika të dallueshme ndaj vendeve të Partneritetit Lindor dhe po ashtu masë me karakteristika shumë të dallueshme sa i përket interesimit për procesin e tërësishëm. Polonia, Suedia dhe Gjermania mund të jenë motor, por duhet t’i përfitojnë edhe vendet e tjera të BE-së për një angazhim më të fortë.

Përfundim

Në qoftë se Bashkimi Evropian dëshiron të ruaj dhe të zgjerojë globalisht pozitën e tij, ai shikimin e vet duhet ta orientojë më fort kah jashtë. Me këtë rast veprimi para derës së shtëpisë së vet tregon posaçërisht qartë, se si është e vendosur BE-ja. Këtu në kuadër të politikës së zgjerimit dhe të fqinjësisë në dorë ka një instrument efikas, të cilin duhet ta përdorë mençur dhe ta përsosë më tej. Më e suksesshme do të jetë BE-ja atëherë, në qoftë se arrin t'i mbërrijë popullsitë e vendeve të ENP-së përkatësisht të vendeve kandidate (potenciale).

Politika e zgjerimit dhe e fqinjësisë kanë nevojë për impulse të reja dhe për angazhimin e fortë të BE-së dhe të shteteve të saj anëtare. Nga Gjermania si vend i BE-së me ndikim, kërkohet dhe ajo është në gjendje që të punojë për më shumë besueshmëri, çiltërsi, transparencë, solidaritet dhe angazhim në ENP dhe në politikën e zgjerimit.

Rreth autorëve

Wolfgang Kreissl-Dörfler është anëtar i Parlamentit Evropian dhe zëdhënës për politikë të jashtme i deputetëve të SPD-së në Parlamentin Evropian.

Dietmar Nietan është deputet në Parlamentin Federal Gjerman dhe zëvendës i zëdhënësit për politikë evropiane në grupin parlamentar të SPD-së në Parlamentin Federal.

Markus Meckel ishte më 1990 ministër i Jashtëm i qeverisë së parë të zgjedhur lirshëm të Republikës Demokratike të Gjermanisë dhe nga 1990 deri më 2009 deputet në Parlamentin Federal të Gjermanisë.

Karsten D. Voigt ishte nga 1976 deri më 1998 deputet në Parlamentin Federal të Gjermanisë dhe nga 1983 deri më 1998 zëdhënës për politikë të jashtme i grupit parlamentar të SPD-së në Parlamentin Federal.

Katharina Abels është bashkëpunëtore shkencore në zyrën e deputetit Dietmar Nietan.

Olaf Böhnke udhëheq zyrën në Berlin të Këshillit Evropian për Marrëdhënie të Jashtme (European Council on Foreign Relations).

Stefan Dehnert është koordinator programor në degën e Evropës Juglindore në seksionin për Evropën e Mesme dhe Lindore pranë Fondacionit Friedrich Ebert.

Dr. Robert Ernecker është referent në grupin parlamentar të SPD-së në Parlamentin Federal.

Sascha Götz mban ueb-faqen www.moe-kompetenz.de. Ai veprimi për deputetët e Parlamentit Federal të Gjermanisë dhe si drejtor i shoqatës MitOst e. V..

Dr. Kai-Olaf Lang drejton aktualisht Grupin hulumtues për integrim në BE të Fondacionit për Shkencë dhe Politik.

Nadja Pohlmann është bashkëpunëtore shkencore te deputeti i Parlamentit Evropian Wolfgang Kreissl-Dörfler.

Klaus Suchanek është bashkëpunëtor i dikurshëm i kryesisë partiake të SPD.

Impressum

Fondacioni Friedrich Ebert
Analiza e Politikës Ndërkombëtare | Departamenti i Dialogut Ndërkombëtar
Hiroshimstraße 28 | 10785 Berlin | Gjermani

Përgjegjës:
Dr. Ernst Hillebrand, drejtor i Analizës Politike Ndërkombëtare

Tel.: ++49-30-269-35-7745 | Fax: ++49-30-269-35-9248

www.fes.de/ipa

Porositjet dhe kontakti përmes:
info.ipa@fes.de

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë detyrimisht të Fondacionit Friedrich Ebert.
Ky botim shtypet në letër të prodhuar nga pylltaria e qëndrueshme.

ISBN 978-3-86498-505-8